



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**VENDIM**  
**Nr. 291, datë 18.06.2026**

**PËR**  
**EMËRIMIN DHE CAKTIMIN GJYQTAR NË NIVEL APELI,**  
**TË ZNJ. INA RAMA**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 166 pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi relacionin shoqërues dhe materialet përkatëse, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Emërimin gjyqtar në nivel apeli të znj. Ina Rama.
2. Caktimin e znj. Ina Rama në pozicionin e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
3. Efektet juridike të këtij vendimi, fillojnë në datën 18.06.2026.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit znj. Ina Rama sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe Gjykatës Administrative të Apelit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**